



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Dokument parlamentar

### PROCESVERBAL

Datë 03.12.2014; ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”
3. Projektligji “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”
4. Projektligji “Kodi i Procedurave Administrative”

#### **Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka, Mark Frroku dhe Tahir Muhedini.

#### **Mungojnë:**

Edi Paloka, Kastriot Islami, Armando Prenga, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Tom Doshi dhe Eduard Halimi

#### **Të ftuar:**

Dritan Dango – këshilltar për marrëdhëniet me parlamentin, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Denada Seferi – drejtoresha e Përkujdesit Shoqëror, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Merita Xhafaj – drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave Sociale.  
Enkelejda Lopari – këshilltare e ministrit  
Kledia Mazniku – drejtoreshë e Shërbimeve Juridike  
Zyber Dushku - komandant i Forcave Tokësore  
Yllka Lamçe - drejtor i Legjislacionit në Ministrinë e Mbrojtjes  
Ervin Kurti – përfaqësues nga Policia Ushtarake  
Edlira Jorgaqi – drejtore e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – E hapim mbledhjen, meqë kuorumi është realizuar.

Pikë e parë e rendit të ditës është Urdhri i Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë.

Kemi votimin në parim dhe shqyrtimin nen për nen.

Kush është dakord në parim?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. “Objekti i ligjit”.

**Ulsi Manja** – Është rënë dakord me përfaqësuesit e Ministrisë për një riformulim të nenit 1. Te rreshti i tretë hiqet fjalia: “Sipas përcaktimeve të këtij ligji”. Riformulohet si vijon: “Objekti i këtij ligji është rregullimi i organizimit dhe i veprimtarisë së Urdhrit të Punonjësve Socialë, si dhe i marrëdhënieve juridike dhe etiko-profesionale të punonjësve socialë”.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Seferi.

**Denada Seferi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Faleminderit!

Zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Janë gjashtë propozime për të cilat i thashë relatorit t’i marrë në konsideratë. Desha ta di paraprakisht: i ka marrë apo nuk i ka marrë në konsideratë?

**Ulsi Manja** – Dje pasdite, pas diskutimeve në parim të projektligjit, jemi konsultuar me përfaqësues të Ministrisë së Mirëqenies dhe të gjitha komentet dhe propozimet, edhe ato të koleges Hysi, janë reflektuar në projektligj.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 2.

**Ulsi Manja** – Edhe për nenin 2 ka një riformulim, si më poshtë: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kriterëve për ushtrimin e profesionit të punonjësit social, garantimi i standardeve etiko-profesionale në ushtrimin e këtij profesioni në mbrojtje të interesit publik, duke respektuar parimin e autonomisë së profesionit të punonjësit social”.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Seferi.

**Denada Seferi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Faleminderit!

Neni 3.

**Ulsi Manja** – Për nenin 3 është rënë dakord që të ndryshohen neni 3 me nenin 4. Thjesht si vendosje.

**Fatmir Xhafaj** – Vazhdojmë me nenin 3 që bëhet 4.

**Ulsi Manja** – Është rënë dakord që të hiqet pika 3.

**Fatmir Xhafaj** – Pika 3: “Profili i administratorit shoqëror”.

Zonja Seferi.

**Denada Seferi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Faleminderit!

Neni 5. Dakord?

Dakord.

Neni 6.

**Ulsi Manja** – Përpara nenit 6, ku flitet për misionin, të shtohen fjalët: “Kreu i dytë”. Ai emërtohet “Misioni dhe buxheti”.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Seferi.

**Denada Seferi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Faleminderit!

Neni 6. Pika 2.

**Ulsi Manja** – Neni 5, pika 2, shkronja “b” ndryshohet si vijon (ky ka qenë propozimi i koleges Hysi): “Krijon dhe përditëson regjistra të posaçëm, sipas fushës dhe veprimtarisë së profileve”.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Seferi.

**Denada Seferi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Kam një sugjerim. Neni 6 është i kompletuar. Sidoqoftë, pyetja ime është: te neni 6, pika 2, a janë të gjitha misionet e Urdhrit të Punonjësve Socialë? Mund të ndodhë që gjatë punës të na dalë një mision i ri. Çfarë do të bëjmë: do të bëjmë prapë ndryshim ligji?

Kam merakun se mos ndoshta pas pesë a gjashtë muajsh do të vijnë të na thonë se do të shtojnë edhe dy misione të tjera. Do ta lëmë kështu, apo do ta lëmë në parim misionin si një

koncept për punonjës socialë dhe pastaj me akt nënligjor, me vendim qeverie, mund të detajohet gjithë realizimi i misionit.

E kam sugjerim.

**Fatmir Xhafaj** – Shikoj një standard.

*(Diskutim pa mikrofon.)*

Pika 2. Kush është shtuar? “Krijon dhe përditëson regjistra të posaçëm sipas...

*(Diskutim pa mikrofon.)*

Dakord.

Zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, te neni 6 thuhet “Misioni”, por në fakt përcakton kompetencat që ka institucioni. Nëse paragrafi i parë është “Misioni”, paragrafi i dytë ka të bëjë me kompetencat. Çdo ligj duhet të parashikojë kompetencat e urdhrat që rregullon. Unë mendoj që këto duhen lënë. Pastaj, a mund të lëmë bashkë “Misioni dhe kompetencat”, është një çështje tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – A mund të bëjmë këtu një riformulim, që të bëni një ndarje të misionit dhe kompetencave?

**Denada Seferi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Faleminderit!

Neni 7.

**Ulsi Manja** – Neni 7 bashkohet me nenin 8. Ka një riformulim të nenit.

**Fatmir Xhafaj** – Ai që keni përpara.

**Ulsi Manja** – Ai që keni përpara, pasi është një formulim i gjatë.

*(Diskutim pa mikrofon.)*

Të gjitha sugjerimet e kolegut Fino në lidhje me nenin 7, pika...

*(Diskutim pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Më fal! A ka mundësi? Nëse doni të flisni, merrni leje dhe ja ku është mikrofon.

Nuk është e thënë që çdo gjë të reflektohet. Në rastin konkret është reflektuar. Meqë shkon një faqe, thashë të mos e lexoj. Nëse doni ta lexoj, e lexoj. Është çështje kohe.

*(Diskutim pa mikrofon.)*

Është reflektuar.

*(Diskutim pa mikrofon.)*

Zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një pyetje për formulimin që i është bërë pikës “b”, pjesës së nënvizuar, ku thuhet: “Kërkesat minimale për formimin dhe kualifikimet profesionale të punonjësve”. Është të zotërojë një diplomë në fushën e punës sociale. Më duket se është kërkesë tepër minimaliste. Nuk ka mbetur njeri pa pasur një diplomë. Sikurse e theksuam edhe në mbledhjen e djeshme, në të gjitha ligjet që kemi kaluar në komision, kemi vënë kritere objektive dhe kritere shtesë më profesionale. Kjo është administrata që do të çojë Shqipërinë në BE. Nuk do të na çojë 40 vjet prapa.

E para, kjo pjesë e nënvizuar duhet plotësuar.

E dyta, në pikën “b”, duhen hequr fjalët e huaja.

Ligji është shqip. Pra, do të lëmë “Certifikata e mirënjohjes”, nëse ekziston një certifikatë e tillë në bazë të ligjit. Janë rregulluar tipat e certifikatave.

**Fatmir Xhafaj** – E para, do të hiqet ajo shprehja në anglisht. Me sa kuptoj unë, është vënë për t’u kuptuar nëse është shqipëruar saktë.

E dyta, mendoj se është e qartë që kriteret profesionale të punonjësve socialë përcaktohen me VKM, me propozim të ministrit përgjegjës. Jo çdo gjë duhet përcaktuar në ligj.

*(Diskutim pa mikrofon.)*

Duhet të ketë diplomën e punonjësit social.

Duhet ta specifikoni?

**Denada Seferi** – Them që këtu ta vëmë se bëhet fjalë për diplomë të nivelit të dytë.

**Fatmir Xhafaj** – Jemi dakord? Dakord.

Miratohet.

Faleminderit!

Neni 10, që bëhet neni 8, me ndryshimin. “Buxheti”. Dakord?

Dakord.

Neni 11.

Dakord? Dakord.

Neni 12. Dakord?

Dakord.

Neni 13. “Bordi”. Dakord?

Dakord.

Neni 14. “Kryetari i Urdhrit të Punonjësve Socialë”. Dakord?

Dakord.

Neni 15. “Komisioni i gjykimit disiplinor profesional”. Dakord?

Dakord.

Neni 16. “Masat disiplinore”. Dakord?

Dakord.

Neni 17. “Ankimimi”. Dakord?

Dakord.

Neni 18. Dakord?

Dakord.

Neni 19. Dakord?

Dakord.

Neni 20. “Hyrja në fuqi”. Neni 21 që bëhet neni 20. Dakord?

Dakord.

Jemi dakord në tërësi? Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka kundër dhe abstenime.

Miratohet me ndryshimet e shqyrtuara.

Faleminderit!

Faleminderit, zonja Seferi! Faleminderit, zonja Mazniku! Faleminderit, zoti Dangu!

Punë të mbarë!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Dokument parlamentar

**PROCESVERBAL**

Datë 03.12.2014; ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Projektligji “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pirro Lutaj, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka, Mark Frroku dhe Tahir Muhedini.

**Mungojnë:**

Edi Paloka, Kastriot Islami, Armando Prenga, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Tom Doshi dhe Eduard Halimi

**Të ftuar:**

Zyber Dushku - komandant i Forcave Tokësore.

Yllka Lamçe - drejtor i Legjislacionit në Ministrinë e Mbrojtjes.

Ervin Kurti - Policia Ushtarake.

Florenc Mihali - këshilltar ligjor i Forcave Tokësore

**Fatmir Xhafaj** – Kalojmë të projektligji “Për disiplinën te Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Për të mbrojtur projektin, nga Ministria e Mbrojtjes kanë ardhur zoti Dushku, komandant i Forcave Tokësore, zonja Lamçe, drejtore e Legjislacionit në Ministrinë e Mbrojtjes, dhe zoti Florenc Mihali, këshilltar ligjor i Forcave Tokësore.

Kemi votuar në parim.

Kemi votimin nen për nen.

Neni 1. Dakord?

Dakord.

Neni 2. Dakord?

Dakord.

Neni 3. “Fusha e zbatimit”. Dakord?

Dakord.

Neni 4.

**Xhemal Qefalia** – Fjalët “t’i nënshtrohet procedimit disiplinor” të zëvendësohen me fjalë “subjekte”.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Lamçe?

**Yllka Lamçe** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 5. “Juridiksioni territorial”. Dakord? Dakord.

Neni 6. Ka ndryshime te ”Përkufizime”?

**Xhemal Qefalia** – Nuk ka.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 7. “Autoritetet përgjegjëse”.

**Xhemal Qefalia** – Nuk ka ndryshime.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 8. “Komisioni disiplinor”.

**Xhemal Qefalia** – Nuk ka ndryshime.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 9. “Komisioni i lartë disiplinor”.

**Xhemal Qefalia** – Nuk ka ndryshime.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 10. “Klasifikimi i shkeljeve disiplinore”.

**Xhemal Qefalia** – Për nenin 10, ka një propozim nga Komisioni i Ligjeve. Pika 27 e nenit 11 të hiqet.

**Zyber Dushku** – Për nenin 10 deputeti Fino na sugjeroi se ishte shumë i gjatë dhe përfshinte 51 masa. Ne kemi bërë një ripunim dhe e kemi bashkuar me nenin pasardhës, me qëllim që të jetë më i kuptueshëm. Duke parë edhe legjislacionin e shumë vendeve të tjera të NATO-s, rezulton se të gjitha këto masa duhet të përfshihen në ligj jo vetëm për shkak të traditës që ligji ynë i ka pasur, por edhe të rëndësisë që ka përfshirja e gjithë këtyre masave në ligjin e disiplinës.

Dua t'ju kujtoj se ligji i Mbretërisë së Bashkuar, është një libër shumë i madh me të gjitha aktet, përbëhet prej 344 faqesh, por edhe i Gjermanisë me 67 faqe. Pra, ne propozojmë që këto të jenë.

**Fatmir Xhafaj** – Kur të keni ju ushtrinë e Britanisë dhe të Gjermanisë, do të vij unë te ju, jo ju në Kuvend.

Gjithsesi, le të mbetemi te fakti që keni reflektuar sugjerimin e kolegëve për ta ndarë dhe e keni përshtatur më mirë. Me sa shoh, e keni ndarë në tri pjesë.

Zoti Fino, keni fjalën.

**Bashkim Fino** – Argumentet e Ministrisë së Mbrojtjes janë shkatërruese, për mendimin tim. Unë e dua ushtrinë si ajo britanike dhe gjermane. Por këta nuk kanë bërë gjë tjetër veçse kanë thënë: “Shkeljet disiplinore do të jenë të lehta, të rënda dhe shumë të rënda”. Ky është një nen shumë i lezetshëm! Më pas kanë marrë nenet 11, 12 dhe 13, ku kanë sqaruar se çfarë është shkelje e lehtë, e rëndë dhe shumë e rëndë, që është baras, për të mos thënë më shumë se neni 10 i ligjit ekzistues.

Pavarësisht shembullit që ju dhatë për Anglinë dhe Gjermaninë, problemi është se ju nuk keni pse t'i lidhni duar vetes suaj duke shkruar masat e lehta, të rënda dhe shumë të rënda në ligj. Ju duhet ta shkruani në ligj që ka shkelje disiplinore të lehta, të rënda dhe shumë të rënda, ku më pas të sqaroni me akte nënligjore disiplinën klasifikuese. Në momentin që e lini kështu, i jepni mundësi shefit të Shtabit, qeverisë, edhe Komandantit të Përgjithshëm po të duash, të nxjerrë një akt jo me kaq pika sa keni nxjerrë ju për nenet 11, 12 dhe 13, por edhe dyfishin po të doni. Gjatë rrugës mund të dalin gjëra të ndryshme, për të cilat ju, për shkak të praktikës dhe të përvojës, mund të shtoni shkelje disiplinore të tjera. Ky është sugjerimi im.

Në momentin që e shkruani te nenet 11, 12 e 13, si dhe mundoheni të jeni të krahueshëm me aktin ligjor të Mbretërisë së Bashkuar apo të Gjermanisë, ju në njëfarë mënyrë e bëni ligjin interesant, por, në fakt, i keni lidhur duart vetes suaj, sepse nesër, kur ka një shkelje

disiplinore më të lehtë, që sot nuk e keni parashikuar në ligj ngaqë nuk ju është dashur, por nga përvoja mund të ndodhë, nuk keni ku ta bazoni. Me sugjerimin që bëj ju jepet mundësia që të bëni një akt nënligjor dhe ta shtoni. Në këtë kontekst ishte sugjerimi im.

Nuk jam kundër shkeljeve sesi i keni klasifikuar ju, ato janë çështjet tuaja. Por do të ishte më mirë që me një urdhër të ministrit, të Kryeministrit apo të shefit të Shtabit ju t'i kishit më të detajuara në çdo kohë. Duke e vënë kështu në ligj nuk ka të drejtë as qeveria, as ministri, as shefi i Shtabit të shtojë edhe një element të vetëm. Nëse praktika do t'ju diktojë juve se duhet të shtohet një shkelje e disiplinës së lehtë, do të vini përsëri në parlament për të bërë një amendament për nenin 11. Ky është thelbi i gjithë asaj që unë kam propozuar dje dhe që nuk është kuptuar, por e kanë sjellë më të detajuar dhe më të ndarë.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Lutaj, keni fjalën.

**Piro Lutaj** – Unë e mbështes parafolësin. Ne kemi një paqartësi dhe do të japim disa opinione për ta kompletuar mirë këtë dispozitë. Unë sugjeroj që këtë nen ta riformulojmë që të jetë më i qartë. Relatori le të bisedojë me personat që kanë ardhur për ta mbrojtur ligjin dhe pas formatimit, sepse e vërteta është që ka një paqartësi...

**Fatmir Xhafaj** – Ky ligj do të kalojë edhe te Komisioni i Sigurisë.

**Piro Lutaj** – Unë mendoj që të mos e kalojmë këtu, sepse atëherë konsiderohet e miratuar.

**Fatmir Xhafaj** – Këtu do të kalohet në parim.

**Piro Lutaj** – Unë jam për ta riformuluar tërësisht këtë nen.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me nenin 10?

**Xhemal Qefalia** – Dakord.

Në lidhje me nenin 11, meqenëse këta janë munduar t'i evidentojnë të gjitha shkeljet, nisur nga praktikat e disa ushtrive të tjera, konkretisht sllovene, propozoj që të shtohet një pikë të “Shkeljet disiplinore të lehta”, ku të vendoset: “Konsiderohet masë edhe pranimi i dhuratave ose përfitimi nga vartësit apo persona të tjerë që kanë lidhje me shërbimin ushtarak”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord?

**Yllka Lamçe** – Dua të bëj një qartësim. Ne patëm sjellë një riformulim të neneve, duke i rigrupuar, nuk e di nëse zoti deputet po lexon mbi këtë variant?

**Fatmir Xhafaj** – Po, patjetër, mbi këtë po lexon.

**Yllka Lamçe** – Atëherë, pranimin e dhuratave ju sugjeroni që ta shtojmë te shkeljet disiplinore të lehta?

**Fatmir Xhafaj** – Po.

Ju lutem, ndiqini kolegët deputetë!

**Petrit Vasili** – Nuk e di a mbetemi në parametrat e miratimit të një ligji po shkruam gjëra të tilla: pirja e duhanit në ambientet që janë të ndaluara me ligj, mosrespektimi i orarit, prishja e qetësisë?

**Fatmir Xhafaj** – I hoqëm ato.

**Petrit Vasili** – Nëse janë hequr, lexoni variantin që ka mbetur.

**Fatmir Xhafaj** – Te cila pikë është kjo?

**Petrit Vasili** – Germa “g”, germa “j” “Prishja e qetësisë kur nuk përbën vepër penale”. Nuk e di sesi përbën vepër penale prishja e qetësisë?! Ka disa gjëra që e ulin shumë nivelin e ligjit.

**Fatmir Xhafaj** – Biem dakord që t’i kalojmë në parim nenet 11 dhe 12, me ndarjen që kanë bërë, dhe më pas relatori le të ulet me ministrinë për ta zgjidhur. Dakord?

Miratohet neni 11, me vërejtjen që do të rishitet.

Neni 12?

Miratohet neni 12 me sugjerimet që u bënë.

Neni 13?

Miratohet neni 13 me sugjerimet që u bënë.

Neni 14? “Masat disiplinore”.

**Xhemal Qefalia** – Te neni 14 ka një ndërhyrje për pikën e tretë të germës “b”, meqë jemi te “Masat disiplinore të rënda”.

Këtu duhet të vendoset fjala “lirim”, sepse “shkarkim” nuk figuron në asnjë vend. Është ndryshe të thuash “lirim” dhe ndryshe “shkarkim nga detyra”.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Vasili keni fjalën.

**Petrit Vasili** – Në rast se ne parashikojmë masat, këtu është një masë disiplinore “Qortimi”, e cila u jepka verbalisht nga autoriteti përgjegjës ushtarak. Nëse janë masa, duhet të përcaktohet mënyra sesi jepet dhe sesi evidentohet. Ne të gjithë e njohim shtetin. T’i themi dikujt “sillu mirë” me gojë nuk janë gjëra i përkasin një ligji. Nuk mund ta kuptojë njeri që kjo është një masë që jepet verbalisht.

**Xhemal Qefalia** – Për t’iu përgjigjur zotit Vasili, nisur nga praktika e shumë vendeve që e kanë rregulloren e disiplinës, këtu bëhet fjalë për një masë që nuk shënohet në librin disiplinor. Domethënë, nuk figuron e shkruar në librin disiplinor, në praktikën e punës për disiplinën që i ndiqet ushtarakut. Kjo është një masë që shumë ushtri të tjera, edhe ato të NATO-s e kanë.

**Petrit Vasili** – Nuk dua të hyj në zanatin tuaj, por, për mendimin tim, një masë që nuk lë gjurmë nuk është masë. Nëse është një masë që është e parashikuar në ligj, por është kaq e lehtë dhe pa gjurmë, atëherë kjo nuk ka pse të jetë në ligj. Kjo është një fjalë e thënë në erë, ky është përkthimi që keni ne për të në gjuhën e zakonshme dhe burokratike. Kështu që le të hiqet kjo dhe të gjendet një vend se ku të vihet. Po vëmë në ligj një masë që as nuk shënohet, as bëhet, asgjë. Po ku mbeti që u tha? Ku u evidentua që ndodhi? Nëse është e përsëritur si do ta evidentojmë ne këtë gjë?

**Yllka Lamçe** – Praktikisht te Forcat e Armatosura ka një natyrë të veçantë të mënyrës sesi ndërtohen marrëdhëniet dhe raportet, sidomos hierarkia e eprorit me vartësin. Megjithatë, kjo nuk bën një përjashtim shumë të madh, po të konsiderojmë se edhe në ligjin “Për nëpunësin civil” është e parashikuar që urdhrat të jepen qoftë verbalist, qoftë me shkrim. Në këtë kuptim jo çdo masë është e mundur që ...

**Petrit Vasili** – Masë do të thotë se unë kam kryer një shkelje, të cilën ligji e ka përcaktuar si të tillë. Pra, kam bërë një gabim, por që është i lehtë, jo i rëndë, dhe për këtë gabim kam edhe një qëndrim të caktuar që është ligjor, sepse është parashikuar në ligj. Edhe gabimi, edhe qortimi duhet të evidentohen diku. Çështja është e tillë: shkelje të lehta njeriu mund të bëjë pafund. Do të vijë një ditë ku do t’i thuhet se janë bërë 1, 2, 3,4 shkelje të lehta dhe këto janë bërë në vijimësi, por këto nuk evidentohen gjëkund. Pra, në ligj mund të shkruhen, por individit jo. Kështu që unë nuk shoh elemente të disiplinës këtu, por gjëra të thëna në erë.

Një disiplinë e qartë dhe ushtarake, që ne synojmë ta vëmë me këtë ligj, i bën gjërat e qarta për ato që ke bërë dhe janë evidentuar.

**Spartak Braho** – Logjika juaj është e saktë. Nesër ushtaraku për një masë ekstreme do të shkojë në gjyq të ankohet. Ku janë të evidentuara masat? Aty thuhet thjesht qortim dhe nuk është e shënuar në libër. Problemi që shtron zoti Vasili është se ku shënohet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Që të kuptohemi për një gjë, duhet të shkojmë te nenet e mëposhtme për të kuptuar si dokumentohen këto masa. Këtu po flasim për masat, më poshtë do të jetë e sqaruar ecuria sesi veprohet dhe më pas dokumentimi i tyre. Do ta shohim, nëse nuk është e sqaruar, do ta shtojmë.

A jeni dakord me nenin 14, me sugjerimet që u bënë? Dakord.

Neni 15 “Raportimi i shkeljeve disiplinore”.

A jeni dakord?

Miratohet.

Neni 16 “Ecuria disiplinore”.

**Xhemal Qefalia** – Është në rregull.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 17 “Të drejtat e ushtarakut gjatë procedimit disiplinor”.

**Xhemal Qefalia** – Është në rregull.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 18?

Zoti Majko, keni fjalën.

**Pandeli Majko** – Unë kam një propozim për nenin 17, që mendoj se duhet parë te komisioni përgjegjës. Disa qendra ushtarake të diskutimit të strategjisë kanë ngritur problemin e të drejtës së ushtarakut për të kundërshtuar urdhrat e paligjshëm. Do t’u lutesha specialistëve ta shikojnë kur ta diskutojnë në parim në komision të drejtën e ushtarakut për të kundërshtuar urdhrat e paligjshëm, sepse është krijuar psikoza se ushtaraku zbaton urdhrat. Unë mendoj se duhet të fillojë të futet ky parim në ushtri. Ne nuk i lejojmë të drejtën e sindikalizmit, por ne duhet t’i njohim ushtarakut të drejtën të kundërshtojë urdhrin e paligjshëm. Këtë me të drejtë, pasi i kërkojmë ushtarakut të bëjë kështu e kështu, madje të mos nxjerrë fotografi në facebook, por që këtë edhe mund ta shikoni me thënë të drejtën, por kundërshtimi i urdhrit të paligjshëm është një diskutim që po diskutohet në të gjitha ushtritë moderne. Do t’u lutesha ta rishikoni te komisioni përgjegjës. Që të marrë guximin një ushtarak të thotë “jo”, duhet ta mendojë 14 herë, por ama këtë të drejtë duhet t’ia njohim, sepse në fund fare ai, ushtaraku, do të shkojë edhe te komisioni i disiplinës bashkë me eprorin dhe do t’i thotë se nuk e zbatova urdhrin për këtë arsye. Përderisa kemi logjikën e komisionit disiplinor ku ushtaraku ballafaqohet me eprorin e vet, është më se normale që komisioni disiplinor të njohë edhe të drejtën e kundërt të ushtarakut për të mos zbatuar urdhrin.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Ky është një sugjerim, ju shikojeni në raport me kuadrin ligjor që ka të bëjë me ushtarakun kur të veni te Komisioni i Sigurisë meqenëse është komision përgjegjës. Nëse nuk është i harmonizuar me kuadrin ligjor, pjesën tjetër le ta sugjerojmë dhe ta vendosë komisioni përgjegjës.

Po, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – Nuk e kam kuptuar dhe dua një shpjegim se për se masat disiplinore në germa “a” dhe “c” të pikës 2 nuk mund t’u jepen ushtarakeve të seksit femër? Nuk e kuptoj dot këtë.

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem para votimit në tërësi do ta diskutojmë edhe këtë.

Neni 18, dakord?

Dakord.

Neni 19, dakord?

Dakord.

Neni 20, dakord me sugjerimet?

Dakord.

Te neni 21, dakord me sugjerimet?

Dakord.

Neni 22, dakord?

Dakord.

Neni 23, dakord?

Dakord.

Te neni 24, dakord?

Dakord.

Neni 25, dakord?

Dakord.

Neni 26, dakord? Po afatin këtu përse nuk e keni vënë?

Dakord, brenda 3 muajve.

Neni 27, dakord?

Dakord.

Neni 28, dakord?

**Armando Subashi** – Aktet nënligjore në fuqi do të qëndrojnë derisa të dalin të rejtat. Bie ligji edhe aktet nënligjore që janë nxjerrë në zbatim të atij ligji...

**Fatmir Xhafaj** - Po mirë janë rregulloret në përputhje me këtë ligj. Po duhet të rregullohet që të mos krijojnë vakuum.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Nuk ka rënie të ligjit. Dakord.

Neni 29, dakord? Dakord.

**Bashkim Fino** – Jam kundër nenit 28. Dhe do të shkoj deri te komisioni përgjegjës e deri në seancë plenare ta mbroj mendimin tim. Jam kundër me një logjikë shumë të thjeshtë. Nëse ne bëjmë një ligj dhe qeveria bie një ligj, nuk ka arsye që të themi se ligjin e bëmë, por duam shumë kohë për të bërë aktet nënligjore dhe sa të bëjmë aktet nënligjore do të mbajmë këto akte nënligjore që kemi. Jo, kjo nuk qëndron.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe një herë, që të kuptohemi, bëmë një ndryshim për ato që nuk bien në kundërshtim.

Atëherë neni 29 dakord.

Para votimit në tërësi kemi disa pika. Pika e parë është që duhet të më sqaroni atë që tha zoti Vasili si bëhet dokumentimi i masave disiplinore dhe si e parashikon ligji. Po, komandanti.

**Zyber Dushku** – Në lidhje me vërejtjen që u bë, ajo qëndron. Të gjitha masat disiplinore në Forcat e Armatosura regjistrohen.

**Fatmir Xhafaj** – Ku është në ligj kjo?

**Zyber Dushku** – Aktualisht kemi një database të krijuar.

**Fatmir Xhafaj** – Ku është në ligj kjo?

**Zyber Dushku** - E kemi te neni 14, pika 4. Të gjitha masat disiplinore të përcaktuara shënohen në dosjen personale të ushtarakut. Unë e pranoj që edhe qortimi duhet të regjistrohet.

**Fatmir Xhafaj** – Si është fjala për pikën 5, që ngriti zoti Vasili, po te ky nen? Një koment, ju lutem, zonja Lamçe.

**Yllka Lamçe** – Po, praktikisht është zbatuar parimi i diskriminimit pozitiv për sa kohë një numër i madh i femrave të angazhuara në Forcat e Armatosura janë familjare dhe, duke qenë se këto ndalime: kufizimi i lëvizjeve, ndalimi disiplinor nënkuptojnë një turrje të së drejtës për të lëvizur, për të vepruar, është menduar që për to është më e drejtë, të mos zbatohet.

**Petrit Vasili** – Unë jam i prerë në këtë pikë dhe do të votoj kundër kësaj, sepse, nëse bëhet fjalë, për një qëndrim që ka të bëjë me masa disiplinore që lidhen me shkelje të rënda, shkeljet e rënda nuk kanë dallim gjinie. Shkeljet e rënda janë të një njeriu në detyrë, i cili ka shkelur detyrën dhe bashkë me shkeljen ka edhe konsekuencat. Shkalla e shtrirjes së tyre është sipas zgjedhjes së atij që ka bërë shkeljen. Kështu që një nga gjerat që ne kemi vënë dhe kemi krijuar në princip ka qenë barazia gjinore. Çështja e diskriminimit pozitiv dhe negativ është pa sens. Barazia gjinore është një parim i shenjtë dhe të funksionojë si i tillë. Duke qenë të barabarta në karrierë dhe promovim, duhet të jenë dhe në dënim. Këto arsye nuk janë absolutisht të plota.

**Fatmir Xhafaj** - Zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** - Te neni 14, ku flitet për masa disiplinore, përcaktohen detyra shtesë dhe punë jashtë orarit. Pyetja ime e parë ka të bëjë me atë që pse ka një dallim midis punës fizike që nuk i jepet oficerit dhe i jepet nënoficerit dhe ushtarakut? Cila është praktika për të dhënë detyra shtesë?

Pyetja e dytë ka të bëjë me punën jashtë orarit. Në bindjen time kjo bie ndesh me Kodin e Punës. Kushdo qoftë, punonjës civil apo ushtarak, nuk mund të punojë jashtë orarit pa pagesë. Ne kemi punë me interes publik, si dënimi penal dhe ju i kenë dhënë këtu ngjyrimin e dënimit penal, por, nëse ju sjell në vëmendjen tuaj një vendim të Gjykatës Kushtetuese, thuhet se dënimet penale mund të përcaktohen vetëm në Kodin Penal dhe jo në ligje të tjera dhe ky është një ligj jo penal.

Gjithashtu, duke u pajtuar tani edhe me shqetësimin e zotit Vasili, ju keni vënë si masa disiplinore të rënda kufizimin e lëvizjes në kufij të përcaktuar. Cili është autoriteti përgjegjës që e jep, sepse është masë shumë e rëndë? Po t'i referohemi Kodit të Procedurës Penale, hyn te masat shtrënguese që ne përdorim? Germa “c” është akoma edhe më e rëndë. Ky është izolimi. Pra, ju e keni zbutur, nuk i keni thënë “izolim”, por të mbash një person 72 orë të izoluar është i njëjtë me izolimin e dikurshëm në burgje, por që e kemi hequr, sepse bie ndesh me standardet evropiane, ju ndërkohe e keni lënë këtu. Masat e rënda që jepen për shkelje të rënda duhet të kenë procedura shumë specifike. E mendoni një person të jetë i sëmurë me diabet apo me zemër dhe ta mbyllësh 72 orë?

**Fatmir Xhafaj** - Po lëre tani se bëhet fjalë për ushtri këtu.

Zoti komandant, urdhëro.

**Zyber Dushku** – Për pyetjen e parë do të përgjigjem unë. Për detyrat shitesë jemi referuar shumicës së legjislacioneve të vendeve që kanë detyra shitesë. Në pikëpamje të ndarjes së oficerëve dhe nënoficerëve, shikohet kondicioni i tyre fizik, pozicioni që ata mbajnë dhe moshën. Ata janë kryesisht në një moshë të re ndërsa oficerët janë në një moshë edhe të shkuar, megjithatë shqetësimin tuaj ne e përmendim në ligj ku thuhet që këto detyra shitesë që “nuk përbëjnë rrezikshmëri për shëndetin dhe që cenojnë dinjitetin e tij”. Pra, nëse ai ka arsye shëndetësore këto merren parasysh dhe trajtohet në mënyrë njerëzore.

**Yllka Lamçe** – Ka qenë një koment që është bërë me Ministrinë Drejtësisë dhe është rregulluar në fakt, por këtu është reflektuar pa dashje versioni i vjetër, ku është përcaktuar “ose që cenojnë dinjitetin e tij”.

Për sa i përket punës jashtë orarit, këtu kthehet në vëmendje specifikat që kanë Forcat e Armatosura, që për çështje operacionaliteti, ushtarakët të angazhohen edhe jashtë orarit dhe të mos paguhen për këtë. Kuadri është i tillë që operacionaliteti të kalojë edhe orarin zyrtar. Kjo është përcaktuar në formën e një mase disiplinore dhe jo të një rregulli të përhershëm, “jo më shumë se 4 orë dhe pa të drejtë page”, që do të thotë ka një kohëzgjatje të përkufizuar në kohë dhe hapësirë.

Nëse më lejoni, ne kemi bërë edhe një sqarim në relacionin shoqëruar të ligjit për të bërë diferencimin me izolimin, sepse kjo masë është konceptuar për situata, kur ushtarakët janë me mision dhe në ambiente të izoluar larg atij që është mjedisi i zakonshëm për Forcat e Armatosura, ku një shkelje e fortë është e nevojshme të dënohet. Pra është konceptuar për ata që janë më shumë jashtë territorit, duke mos pasur kohën e mjaftueshme që të gjykohej dhe të ezaurohen të gjitha shkallët e një procedimi.

Tjetra është çështja e lirimit. Lirimi nga Forcat e Armatosura është vetëm i tillë. Nuk ka lirim dhe shkarkim nga Forcat e Armatosura, ka lirim dhe shkarkim nga detyra. Ky është një konfuzion që na ndodh shpesh në fakt. Dhe kemi konceptuar si masë ekstreme lirim nga Forcat e Armatosura, kurse emërimi dhe shkarkimi janë konceptuar në një ligj tjetër, ku lirim dhe shkarkimi i ushtarakëve është një diskrecion i ministrit të Mbrojtjes, kur bëhej fjalë për oficerët dhe jo autoritetet e tjera, kur vijmë te nënoficerët dhe duke zbritur në hierarki. Pra, këtu ne kemi folur për lirim nga Forcat e Armatosura.

**Fatmir Xhafaj** – Po. Faleminderit!

**Zyber Dushku** – Zoti kryetar, thjesht dua të korrigjoj diçka. Ndalimi disiplinor dhe kufizimi i lëvizjes në kufi të caktuar nuk është vetëm për jashtë, por edhe për brenda dhe ekziston në të gjitha kodet ose aktet disiplinore të të gjitha ushtrive të NATO-s pa përjashtim.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Lutaj.

**Piro Lutaj** – Unë do të përqendrohem te pika 3 e nenit 14. Drejtoresha u mundua, i parapriu ndoshta asaj çka duhet të them. Janë parashikuar masa disiplinore për shkelje shumë të rënda dhe janë parashikuar dy masa. Vërejtje me paralajmërim. Por për çfarë? Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë është: Pse e keni shmangur shkarkimin nga detyra si masë? Është një nga masat e rënda, nga më të rëndat, se ka të bëjë me ndërprerjen e karrierës së një ushtaraku dhe ju ia delegoni një ligji tjetër. Sigurisht shumë elemente të këtij ligji janë përfshirë te ligji tjetër për autoritetet e komandimit dhe të drejtimit, por unë mendoj që të qartësohemi se çdo të thotë vërejtje me paralajmërim, për largim nga detyra, për shkarkim nga detyra. Sipas mendimit duhet parashikuar shkarkimi nga detyra. Para se njeriu të lirohet nga Forcat e Armatosura dhe ta ndërpresë përfundimisht karrierën, duhet të ketë një masë shkarkimi nga detyra për paaftësi, për shkelje. Kështu që ajo u munduat të thoshit ju, që koncepti shkarkim nga detyra i përket një ligji tjetër nuk besoj se është argument bindës.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Yllka Lamçe** – Pra, vërejtja me paralajmërim vërtet është titulluar si e tillë, por ka shpjegimin më tutje, është masë me shkrim për lirim nga Forcat e Armatosura.

Pra, e para vjen një vërejtje. E dyta vjen lirimi nga forcat. Ndoshta ka vend për të përfshirë atë që është shkarkimi nga Forcat e Armatosura. Unë po thosha që ne e kemi përmendur në një ligj tjetër që është ai i karrierës. Nuk e di nëse do ta kategorizonim dot te masat për shkelje shumë të rënda, apo do ta fusim te shkeljet e rënda, por është diçka që ne mund ta konsiderojmë.

**Fatmir Xhafaj** - Para se të më jepni mua sqarimin bëni mirë që kur t'i sillni projektligjet këtu t'i shihni më me vëmendje. Kjo është gjëja më e mirë që mund të bëni.

Biem dakord për votimin në tërësi, ndërkohë vërejtjet që u bënë nga zonja Hysi, zoti Vasili dhe zoti Lutaj, do t'i lutem relatorit t'i përfshijë si rekomandime për Komisionin e Sigurisë për t'u shqyrtuar.

Pra, të ndjekim këtë logjikë duke mbajtur në konsideratë ndryshimet që miratuam nën për nen, sugjerimet e 3 kolegëve për komisionin përgjegjës, zonjës Hysi, zotit Vasili dhe zotit Lutaj.

Kush është dakord në tërësi?

Miratohet me vërejtjet, sugjerimet përkatëse dhe rekomandimet për Komisionin e Sigurisë.

Faleminderit, zoti gjeneral, zonja drejtoreshë, zoti këshilltar!

Punë të mbarë!



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Dokument parlamentar

### PROCESVERBAL

Datë 03.12.2014; ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Projektligji “Për Kodin e Procedurave Administrative”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka, Mark Frroku dhe Tahir Muhedini.

**Mungojnë:**

Edi Paloka, Kastriot Islami, Armando Prenga, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Tom Doshi dhe Eduard Halimi

**Të ftuar:**

Edlira Jorgaqi – drejtore e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

**Fatmir Xhafaj** - Vazhdojmë me pikën e tretë, projektligji “Për Kodin e Procedurave Administrative”. Kemi votuar projektligjin në parim.

Tani kemi votimin nen për nen. Relatori ka një koment para se të fillojmë nen për nen.

**Armando Subashi** - Faleminderit!

Besoj që e mbani mend, e kemi miratuar projektligjin në parim. Jemi në diskutimin nen për nen. Gjatë gjithë kësaj kohe ne kemi zhvilluar një proces, kemi ngritur një grup ekspertësh pranë Komisionit të Ligjeve duke përfshirë jo vetëm këshilltarët që ndodhen këtu, por edhe ekspertë të jashtëm, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Drejtësisë. Kemi punuar vazhdimisht gjatë kësaj kohe duke i marrë të gjitha nenet një për një. Sigurisht që përpara keni një draft të ndarë në dy pjesë ku majtas është ashtu siç ka ardhur projektligji nga qeveria dhe në kolonën djathtas janë propozimet që do të bëhen prej meje si relator i këtij projektligji. Bëhet fjalë për Kodin e Procedurave Administrative, ligji bazë mbi të cilin vepron përditë administrata shtetërore në të gjithë veprimtarinë e vet, në të gjithë procedurën e vet. Kështu që mendoj se është shumë i rëndësishëm si moment.

Meqë jam këtu menjëherë propozimi vjen lidhur me nenin 1. Pra, propozohet që të shtohet një nen përpara se të vijmë te neni 1 i projektligjit të ardhur, i cili të pasqyrojë qëllimin e ligjit. Është në fakt një praktikë legjislative që ndiqet gjithandej, veç fushës së zbatimit të parimeve etj., një nga nenet që përcaktohet në nenet e para është edhe qëllimi i ligjit të cilin ne e kemi përfshirë dhe propozojmë që të marrë numrin 1. Kjo pastaj do të bëjë që të gjithë nenet e mëpasme të draftit të numërtohen me numrat vijues. Pra, propozohet që të shtohet një nen duke marrë numrin 1.

**Fatmir Xhafaj** – Ministria me nenin 1. Jeni dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 2. Jeni dakord me numërtimin?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Kolegë e keni përpara draftin.

Neni 2 që numërtohet neni 3. Nuk po e referoj më këtë të numërtimit që është i bazuar me ndryshimet e bëra bazuar në propozimet e SIGMA-s dhe relatorit të projektligjit.

Jeni dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Me ndryshimet e paraqitura. Dhe ju e keni bërë një faqe nen më në fund.

Neni 3 që numërohet 4 te pika 2, me ndryshimin që keni në tabelë.

Jeni dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 4 që numërohet neni 5 i ndarë në dy nene të veçanta, që është sipas sugjerimit të konferencës gjyqësore.

Jeni dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 6. Pas nenit 6 thuhet neni 7 si vijon: parimi i mbrojtjes së sekretit shtetëror.

**Fatmir Xhafaj** – Jeni dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Pas nenit 7 shtohet neni 8: parimi i mbrojtjes së konfidencialitetit.

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Pas nenit 9 shtohet neni 10 : parimi i ndihmës aktive ndaj palës.

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 5 numërohet neni 10 me propozim të SIGMA-s: parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Gjithashtu me propozim të SIGMA-s neni 6 numërohet neni 8 dhe riformulohet sipas propozimit të ekspertëve të SIGMA-s: parimi i profesionalitetit.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ekspertët e SIGMA-s kanë propozuar që neni 7 të hiqet. Jeni dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 8 ndahet në dy nene në nenin 12 dhe nenin 13, sipas propozimit që kanë bërë, referuar dhe propozimeve që kanë bërë ekspertët e SIGMA-s duke u emërtuar: parimi i drejtësisë dhe i paanësisë dhe parimi i objektivitetit.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Sipas propozimit të SIGMA-s ekspertëve përkatës neni 9 numërohet 14 dhe riformulohet: parimi i përgjegjësisë, neni 14.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Me propozim të ekspertëve është reflektuar propozimi i ekspertëve neni 10 ku numërohet 15 dhe ndryshohet si e keni në tabelë: parimi i kontrollit administrativ dhe atij gjyqësor me dy pikat përkatëse a dhe b.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 11, parimi i mbrojtjes së sekretit shtetëror dhe konfidencialitetit për shkak të zhvendosjes që u bë në nenet e mëparshme hiqet, meqenëse është bërë kalimi atje.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 12: parimi i bashkëpunimit të administratës me personat privatë keni rënë dakord që të hiqet?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 13 numërohet neni 16 dhe formulohet si vijon. Pra, neni me titullin: parimi i marrjes së vendimeve.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 14 numërtohet 17 dhe nuk pëson ndryshime.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 15: parimi i mosdiskriminimit numërtohet 18 dhe nuk pëson ndryshime.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 16: parimi i deburokratizimit dhe i eficiencës numërtohet neni 19 dhe në përmbajtjen e tij togfjalëshi “procedim administrativ” zëvendësohet “me procedura administrative”.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 17: parimi i informimit dhe i ndihmës hiqet.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 18: parimi i mbrojtjes së të dhënave numërtohet 20 dhe nuk pëson ndryshime.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 19: parimi i mospagimit në procedurë administrative emërtohet nga parimi i mospagimit të procedimit nga parimi i mospagimit në procedurat administrative dhe ndryshohet si vijon sipas paraqitjes që keni këtu.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Pas nenit 20 shtohet me propozim të ekspertëve të SIGMA-s neni 21 si vijon: gjuha dhe përkthimi në procedurën administrative.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Titulli i pjesë së dytë dhe kreut të parë duhet ndryshuar para fjalës “kompetencë” dhe do të shtohet “juridiksioni” dhe neni 20 riformulohet si vijon sipas propozimit të bërë. Përcaktimi i juridiksionit dhe kompetencës.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 21 bëhet nga “konstatimi i kompetencës” në verifikimi i kompetencës, por me përmbajtje të njëjtë.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 22, kompetencat lëndore hiqet.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 23: kompetencat tokësore hiqet.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 24 do të shikohet në raport me nenin 29: kompetenca dy ose më shumë organeve.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit

Neni 25 pika 1 germa “b” pas fjalës “njoftohet” shtohet fjala “menjëherë”.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Pika e 2 e po këtij neni ndryshohet si vijon. Po, gjithashtu, edhe pika 3 ndryshohet sipas paraqitjes që keni bërë këtu.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 26: ndalimi i heqjes nga kompetencat.

Dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 27: kompetencat në raste urgjente, keni dy variante: Organi më i lartë në shkallë hierarkike ju shkon ju për vend të parë apo jeni prefekt në nivel vendor dhe Kryeministër në nivel qendror?

**Armando Subashi**- Ndoshta vlen ta diskutojmë dhe me kolegët për momentin.

**Fatmir Xhafaj**- Do do të tërhiqeni?

**Armando Subashi**- Tani për tani mund të qëndrojmë dhe të zgjedhim një nga këto.

**Fatmir Xhafaj**- Dakord, e lëmë të hapur nenin 27.

**Armando Subashi** - Ideja është, kur organi më i lartë...

**Edlira Jorgaqi** - Mund të ndodhi që s'ka organ hierarkik më të lartë.

**Fatmir Xhafaj** -Më jepni një rast ku nuk ka organ hierarkik më të lartë.

**Bashkim Fino** - Bashkia, Këshilli Bashkiak nuk ka organ më të lartë hierarkik. Është Bashkia dhe Prefekti, si nuk ka?

**Edlira Jorgaqi** - Po nuk është organ hierarkik.

**Bashkim Fino** - Si nuk është më i lartë? Është organ epror? Është nivel i dytë, është i i votuar.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord, ta lëmë këtë për diskutim? Gjithsesi, gjeni një zgjidhje.

Neni 28 dhe 29 shkrihen në të njëjtin nen me përmbajtjen si vijon te mosmarrëveshja e kompetencave. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj**- Faleminderit!

Neni 29, zgjidhja e konflikteve të kompetencës, meqenëse u shkrin bashkë, hiqet. Neni 30, kundërshtimi i kompetencës me sugjerim hiqet sepse përmbajtja e kësaj dispozite është mbuluar plotësisht nga pjesa 6, që do të vijë më mbrapa. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Vlerësim për ekspertët e SIGMA-s. Neni 31, hiqet sepse e kaluam te neni 13. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj**- Bazuar në sugjerimet fillestare të SIGMA-s, për të hequr dispozitat mbi delegimet e kompetencave, si dhe sugjerimet e Ministrisë së Drejtësisë për të rishikuar në mënyrë të plotë këto dispozita, grupi ekspertëve i ka përmbledhur dhe harmonizuar ato në përputhje me ligjin për administratën shtetërore.

Neni 32, delegimi i kompetencave, sugjerohet të ndryshohet si vijon.

Dakord, Ministria?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj**- Pas nenit 32, shqyrtohet neni 33 me përmbajtje si vijon procedura e delegimit. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 33, hiqet sepse është përfshirë te neni për ndalimin e nëndelegimit të kompetencave, dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj**- Neni 34, hiqet sepse është përfshirë në nenin për procedurën e delegimit. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj**- Neni 35, hiqet sepse është përfshirë në dispozitën për procedurën e delegimit. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 36, hiqet sepse është përfshirë në dispozitën për procedurën e delegimit. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 37, hiqet sepse është përfshirë në dispozitën për procedurën e delegimit. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 38, zëvendësimi me ndryshimet e bëra. Dakord?

Falemiderit!

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj**- Neni 39, pengesat ligjore me ndryshimet e bëra në pikën shkronja c, në pikën 2 shkronja g dhe pas pikës gj sugjerohet të shtohet shkronja k si vijon në çdo rast kur bashkohen. Pra, me këto ndryshime. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 40, bëhen shtesat e ndryshimeve në pikën 3, shtohet pika 4 e nenit 40, hiqet dhe s'postohet si pikë 3 e nenit 41 si më poshtë. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj**- Neni 41, ndryshohet si vijon vendimmarrja dhe efektet e përjashtimit si emërtohet neni. Dakord?

**Edlira Jorgaqi**- Dakord.

**Fatmir Xhafaj**- Neni 42, hiqet. Dakord?

Neni 43, gjithashtu. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj**- Neni 44. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Kudo ku u përdor shprehja e zëvendësimeve të sasisë, zëvendësohet me procedurë administrative. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 45, sugjerohet të ndryshohet si vijon sipas variantit të ekspertëve të SIGMA-s, zotësia për të vepruar në procedimin administrativ. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** -Dakord.

**Fatmir Xhafaj**- Faleminderit!

Neni 46, meqë për efekt përsëritjeje hiqet. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 47 pika 2, hiqet. Neni 48 pika 3 shkronja a, fjala “e papërcaktuar” zëvendësohet me “e panjohur” dhe në pikën 5 fjala “shfaqje” zëvendësohet me “paraqitje”. Me këto ndryshime të vogla, neni 48, përfaqësuesi i caktuar i kryesisë. Dakord?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Nenet 49 dhe 50 do të rishikohen. Dakord deri këtu?

**Edlira Jorgaqi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - E mbyllim këtu për sot, për shkak të një impenjimi tjetër të komisionit në orën 12:00.

Edhe një herë, faleminderit Ministrisë së Drejtësisë për konstruktivitetin dhe bashkëpunimin!

Faleminderit këshilltarëve dhe ekspertëve të angazhuar! Faleminderit medies!

## **MBLEDHJA MBYLLET**